



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/93 Nr. i faq/Br.str/No.pg 83

Data/Datum/Date 26/01/2026

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 18 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 26.01.2026 miraton këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës

1. **Miratohet** vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi ka këtë përbërje:
 - 2.1. **Bujar Mustafa**, anëtar nga kuvendi i Komunës - LVV;
 - 2.2. **Yllka Shehu**, anëtare nga kuvendi i Komunës - LDK;
 - 2.3. **Afrim Dina**, anëtar nga ekzekutivi i komunës;
 - 2.4. **Afrim Limani**, anëtar nga ekzekutivi i komunës;
 - 2.5. **Adelina Paqarizi**, anëtar nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për shqyrtimin e ankesave janë: shqyrtimi i ankesave që paraqiten nga palët e pakënaqura ofertuese pas procesit të vlerësimit final të ofertave, të përzgjedhura të përzgjedhura nga ana e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtës dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, dhe atë:
 - 3.1. Refuzimin e ankesës dhe lënien në fuqi të procesit të vlerësimit final të ofertave;
 - 3.2. Miratimin e ankesës dhe shfuqizimin (revokimin) e procesit të vlerësimit final të ofertave.
4. Mandati i komisionit për shqyrtimin e ankesave është 2 (dy) vjeçar.
5. Kuvendi i Komunës e ruan të drejtën e ndryshimit dhe plotësimit të këtij vendimi kurdoherë që e shih të arsyeshme.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për

Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Kuvendit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËSNË RAHOVEC

01Nr. 93/26
Datë:26.01.2026



Fatmir Iska

Kryesues i Kuvendit